

Konfederata Zvicerane

Departamenti Federal i Punëve të Brendshme

Departamenti Federal i Sigurimeve Shoqërore

## **Njoftim për media**

29. Janar 2010

### **Përfundon marrëveshja për sigurime sociale me Kosovën**

Marrëveshja për sigurime sociale e lidhur me ish-Jugosllavinë nuk do të zbatohet prej 01. prill 2010 në raport me Kosovën. Parimisht nga kjo – si në rastet e qytetarëve të shteteve tjera joanëtare të kontratës – pensionet e reja tanimë do të paguhen vetëm në rast vendbanimi dhe qëndrimi në Zvicër.

Në dhjetor 2009 Këshilli Federal ka vendosur që marrëveshjet në mes të Serbisë dhe Zvicrës, të cilat ishin në fuqi në kohën e pavarësisht të Kosovës, të mos vazhdojnë në raport me Kosovën.

Nga ky vendim në fushën e sigurimeve shoqërore janë prekur marrëveshja për sigurime shoqërore me ish-Jugosllavinë e vitit 1962 dhe marrëveshja administrative përkatëse e vitit 1963. Zbatimi i saj në raport me Kosovën përfundon më 31 mars 2010. Marrëveshja e atëherëshme e lidhur me Jugosllavinë dhe marrëveshja e përkohshme që zbatohet në raport me Kosovën nuk i përgjigjet më legjislacionit të të dy vendeve.

Që nga 1 prilli 2010, për qytetarët e Kosovës lidhur me sigurimet shoqërore do të zbatohen rregullat për anëtarët e shteteve jokontraktuese. Në vend të dispozitave të marrëveshjes do të përdoren rregullat zvicerane për sigurime shoqërore.

Në përgjithësi – si për qytetarë të të gjitha shteteve tjera jokontraktuese- pensionet do të paguhen vetëm tek rastet që janë me vendbanim dhe qëndrim në Zvicër. Të drejtat e fituara konform dispozitave të marrëveshjes mbesin të pandryshuara/paprekura. Më saktësisht, kjo do të thotë se një pension invalidor, i cili tashmë është duke iu paguar një shtetasi kosovar, do t'i paguhet edhe më tej, edhe në rast vendbanimi jashtë Zvicrës. Ndërsa, një pension invalidor i ri nuk do të eksportohet jashtë shtetit. Në të kundërtën, shumat e paguara të AHV (punëmarrësit dhe punëdhënësit) mund të kthehen përmes një kërkesë në rast kthimi në vendlindje. Shtetasit kosovarë mund të kërkojnë edhe pagesë në kesh të përfitimeve vetjake të pensionit kur ata largohen përgjithmonë nga Zvicra. Si shtetasit e të gjitha shteteve tjera jokontraktuese edhe kosovarët nuk do të kenë të drejtë në shtesa për fëmijë, të cilët nuk kanë vendbanim në Zvicër.

Departamenti Federal për Sigurime Shoqërore

Komunikatë

Informata:      Kommunikation BSV  
Tel: 079 707 03 60  
[kommunikation@bsv.admin.ch](mailto:kommunikation@bsv.admin.ch)  
[www.bsv.admin.ch](http://www.bsv.admin.ch)